



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



Në baze të nenit 3 të Rregullores nr.08/2017 , për praktikantë vullnetarë (pa pagesë) në **Gjykatën Themelore në Prishtinë –Degët e saj**, më 03.10.2023, shpall :

KONKURS
Nr. 02/2023

I-Titulli i vendit të punës: Praktikant/ë vullnetar/e 40 (Dyzetë) pozita
Dega Fushë Kosovë 6 pozita (gjashtë)

Nëpunësi mbikëqyrës: Administratori i Gjykatës

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej një viti (pa pagesë)

Vendi: Gjykata Themelore Prishtinë

Përshkrimi i detyrave të punës:

Detyra e praktikantit: Ndhmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

Detyrat kryesore: Vepron në mbikëqyrjen e drejtpërsëdrejti të kryetarit të Gjykatës dhe në mbikëqyrjen e përgjithshme të administratorit të Gjykatës;

Ndhmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi ;

Ndhmon gjyqtarët në punë që kanë të bëjnë me futjen e lëndëve në dosje;

Ndhmon në punën e zyrave të ndryshme në Gjykatë, duke përfshirë regjistrimin, gjykimet etj; Kryen edhe punë tjera sipas nevojës:

Kualifikimet:

- Diploma e Fakultetit Juridik programi i studimeve (4) vjeçar apo 240 kredi ECTS ose Master,

VEREJTJE:

- Procedura e konkursit është e hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi shërbimin civil Nr.03/L-149 dhe Rregullore, Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil dhe Rregullores për Procedurën e Rekrutimit të Praktikantëve.

- **Konkursi është publikuar më dt. 03.10.2023 dhe mbyllet me dt.17.10.2023**

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Pallati i Drejtësisë , objekti A - Lagjja "Prishtina e Re", Rr.:" Nekibe Kelmendi" pn, gjithashtu aplikacioni mund të shkarkohet nga web faqja e KGJK-së.

Dorëzimi i aplikacioneve mund te bëhet edhe përmes postës.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në tel: 038/200-17-366, prej orës 08:00 - 16:00.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, pragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madhe të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkurron. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata të tjera, dy rekomandime etj.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjiten dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin prapa.

[Shkarko Aplikacionin](#)